

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	81 vite burg nuk mjaftojnë, Prokurorja e Specializuar: Do kërkojmë në Apel dënim edhe për krimet kundë r njerëzimit
ADRESA	https://kohajone.com/kosova/81-vite-burg-nuk-mjaftojne-prokurorja-e-specializuar-do-kerk-ojme-ne-apel-denim-edhe-per-krimet-kunder-njerezimit/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 16:13:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 16:10:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ff8ead38895f514286561a5c49019cf7abd7fb24e9c990905ae49047f15ef955
TEKSTI	7069dbf8d9bd349271adfb3595d160fdb1b160d709da498c45114214511be3bb
PAMJA	7563da6cb4ff23b233f34748c8669522f4539313d2b5f020a0ad49ede1aa9c21

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9a7849d624a987914e499682142426d6d4a580b4e3819ebf74a94a672e899023
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6d78d2dc60f31cde5fa6ff278c9155b75ea76fff53014b2b93764708aa00c94f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9a7849d624a987914e499682142426d6d4a580b4e3819ebf74a94a672e899023>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

81 vite burg nuk mjaftojnë, Prokurorja e Specializuar: Do kërkojmë në Apel dënim edhe për krimet kundër njerëzimit

KOSOVA LAJME E MËRKURË, 16 SHTATOR 2026 18:10



Pavarësisht vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, që i dënoi katër ish-krerët e UÇK-së me një total prej 81 vitesh burgim, Prokuroria e Specializuar nuk e konsideron të mbyllur betejën ligjore.

Zyra e Prokurorit të Specializuar ka bërë të ditur se do ta analizojë në detaje aktgjykimin dhe mund ta dërgojë çështjen në Gjykatën e Apelit, me fokus të veçantë të akuzat për krime kundër njerëzimit. Kryeprokurorja Kimberly West ka theksuar se vëmendja e ZPS-së do të përqendrohet veçanërisht te gjashtë pikat e aktakuzës për këto krime, për të cilat trupi gjyqësor nuk dha dënime.



Deklarata e plotë:



Prokurorja e Specializuar Kimbërlit Uest (Kimberly West) mirëpriti aktgjykimin e sotëm në gjyqin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit duke e quajtur atë të rëndësishëm për sundimin e ligjit në Kosovë dhe drejtësi të vonuar për viktimat.

Trupi gjyqësor vendosi që secili nga katër të akuzuarit mban përgjegjësi penale individuale për krimet e luftës të arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme. Z. Thaçi u dënua me 25 vjet burgim, Z. Veseli me 18 vjet, Z. Selimi me 13 vjet, dhe Z. Krasniqi me 25 vjet.

"Vendimi i sotëm, që bazohet vetëm në fakte dhe ligj, është i rëndësishëm për vënien para përgjegjësisë dhe sundimin e ligjit në Kosovë," tha Prokurorja e Specializuar. "Gjykata ka konfirmuar se asnjë individ, pavarësisht rangut apo autoritetit politik, nuk është mbi ligjin dhe nuk ka imunitet nga përgjegjësia për krime të rënda ndërkombëtare."

Prokurorja e Specializuar theksoi se çështja gjyqësore që ZPS-ja paraqiti kishte të bënte me përgjegjësinë penale individuale dhe nuk vë në dyshim ndonjë narrativë historike.

"ZPS-ja bën përgjegjësi individë për veprimet e tyre, në përputhje me mandatin e saj, asgjë më shumë," vazhdoi Znj. Uest. "ZPS-ja nuk ka ndjekur penalisht Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, as luftën e bërë për pavarësinë e Kosovës.

"Individë të caktuar shfrytëzuan ato rrethana të luftës për të kryer krime të rënda, dhe është për meritë të Kosovës që këta individë nxirren tani para përgjegjësisë."

Në procesin e paraqitjes së provave të saj, ZPS-ja thirri për të dhënë dëshmi drejtpërdrejtë në sallën e gjyqit 125 dëshmitarë dhe paraqiti si dëshmi rreth 3 000 prova materiale të ZPS-së në shumë gjuhë.

LAJMET KRYESORE



Presidenti Begaj reagon pas vendimit të Gjykatës në Hagë: Trishtim i thellë! Askush nuk e njollos UÇK-në



Tensione pranë Gjykatës Speciale në Hagë



Vendimi tronditës! Gjykata Speciale dënon Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin



Dita e verdiktit, Gjykata Speciale jep sot vendimin për ish-krerët e UÇK-së



Videokartolinë e një dite të bukur miqësie dhe përbashkësie në Napoli

TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spallettit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

Trupi gjykues konstatoi në aktgjykimin e tij se zotërinjtë Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi ishin fajtorë për arrestim dhe ndalim të paligjshëm ose arbitrar kundër të paktën 385 personave, trajtim mizor kundër të paktën 49 personave, torturës kundër 303 personave dhe vrasjes së paligjshme kundër të paktën 96 personave.

Krimet u kryen kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime në një periudhë nga prilli i vitit 1998 deri në 20 qershor të vitit 1999 në komuna në të gjithë Kosovën dhe në dy rrethe në Shqipërinë veriore.

Prokurorja e Specializuar vuri gjithashtu në dukje se Zyra e ZPS-së do ta shqyrtojë të gjithë aktgjykimin me kujdes ditët e ardhshme, përfshirë gjashtë pikat e aktakuzës për krime kundër njerëzimit që nuk çuan në dënime.

ZPS-ja mbetet e angazhuar që të garantojë llogaridhënien dhe të mbështesë të drejtat e viktimave ndërsa procesi gjyqësor kalon në fazat e mëpasshme.

MË SHUMË NGA KOSOVA

Kroacia reagon për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së: Nuk ndryshon kont...



Luiz Ejlli reagon pas aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së: Sot fol...

Djali i Jakup Krasniqit reagon pas dënimeve: Ata janë të fortë, krena...



Protestë para EULEX-it në Prishtinë pas aktgjykimit ndaj ish-krerëve ...

Pas vendimit në Hagë, protestuesit hedhin gurë drejt Qeverisë së Koso...



Serbia reagon pas dënimeve në Hagë

LAJMET E FUNDIT



Spahiu për dënimin ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së: Kjo është vetëm beteja e parë, Apeli mund të ndryshojë vendimin

[15 MINUTA MË PARË](#)



Milani dhe Juventus synojnë Europa League, për prestigj dhe për të mbushur arkat

[42 MINUTA MË PARË](#)

Kroacia reagon për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së: Nuk ndryshon kontekstin historik të luftës në Kosovë!

[1 ORË E 1 MINUTË MË PARË](#)



Djali i Jakup Krasniqit reagon pas dënimeve: Ata janë të fortë, krenarë dhe me ndërgjegje të pastër

[1 ORË E 20 MINUTA MË PARË](#)

Pas vendimit në Hagë, protestuesit hedhin gurë drejt Qeverisë së Kosovës në Prishtinë

[1 ORË E 36 MINUTA MË PARË](#)

Luiz Ejlli reagon pas aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së: Sot foli gjykata, nesër do të flasë apeli!

[1 ORË E 49 MINUTA MË PARË](#)

KOHA JONE

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991
Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

SD